



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2022:209559

Datë: 01.03.2024

Numri i dokumentit: 05400991

P.nr. 434/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Besnik Sheqiri, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Erblina Aliu, në çështjen penale kundër të pandehurit B. G., për shkak të veprës penale “Rrezikimi i trafikut publik” nga neni 370 par. 8 lidhur me par. 6 dhe par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.4653/22, të datës 18.09.2023, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar të hapur për publikun, të mbajtur me datë 07.02.2024, në prezencë të prokurorit të shtetit Rukije Sheshivari, të pandehurit dhe mbrojtësit të tij av. V. H. sipas autorizimit, me datë 08.02.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 01.03.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

B. G., nga i ati U. dhe nëna R., mbiemri i vajzërisë së nënës R., data e lindjes ..., në fshatin S., Komuna P. u edhe tani jeton, letërnjoftimi ..., ka të kryer shkollën e mesme, me profesion punëtor në pompën e derivateve “P.. C.”, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka qëndruar në masën e arrestit shtëpiak nga data 11.10.2022, deri me datë 11.11.2022.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

I. Me datë 11.10.2022, rreth orës 07:05, në rrugën “...”, në fshatin S. në drejtim të P., i pandehuri B. G., duke drejtuar automjetin e tipit “...”, transporter, ngjyrë e ..., me targa ..., nga pakujdesia e në kundërshtim me Ligjin nr.05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor, ka rrezikuar pjesëmarrësit në komunikacion dhe ka vu në rrezik jetën e njerëzve, ashtu që duke mos e përshtatur shpejtësinë e lëvizjes së mjetit me kushtet e rrugës (kthesë) dhe kushteve klimatike (moti me shi asfalt i lagur), humb kontrollin ndaj automjetit dhe automjeti fillon të bartet nga skaji i djathtë i rrugës dhe kalon jashtë rruge duke e goditur me anën e djathtë të automjetit dy drunjë dekorues dhe rrethojën e oborrit nga betoni dhe shufra metali pronë e N. Ll., me ç ‘rast shkaktohet aksident komunikacioni ku i dëmtuari pasagjeri në automjet V. J. si pasojë e

aksidentit pëson plagë çarëse-shqyese të indeve të buta në regjionin e mjekrës dhe në laprën e veshit të djathtë, gjendje pas humbje traumatike të thellë e vetëdijes, shembje (ndrydhje) hemorragjike trunore në të dy anët tërthore të trurit, trupit kalloz dhe përreth barkushes së djathtë të trurit, iskemi (pakësim i gjakut) në regjionin e anës së djathtë të trurit të vogël dhe në regjionin ballor të anës së djathtë të trurit, thyerje e kockës së zgjatimit spinos të unazës së 5-të dhe të 6-të të qafës, hemiparezë e anës së djathtë dhe çrregullim i të folurit (disfazi), e të cilat paraqesin dëmtime të rënda trupore.

- me këtë ka kryer veprën penale “Rrezikimi i trafikut publik” nga neni 370 par. 8 lidhur me par. 6 dhe par. 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në kuptim të dispozitave ligjore si më lartë dhe neneve 4, 7, 17, 23, 38, 46, 47, 48, 49, 50, 69, 70 dhe 79 të KPRK-së, si dhe neneve 364, 367, 449 dhe 462 par. 2 të KPP-së, të pandehurin e:

G J Y K O N M E D E N I M M E K U S H T

I. Ashtu i cakton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, në kuadër të cilit i llogaritet edhe koha e kaluar në masën e arrestit shtëpiak, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në periudhën e verifikimit prej një (1) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale.

II. DETYROHET i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale për ekspertizë të komunikacionit të paguajë shumën prej njëqind e pesëdhjetë (150) Euro, për ekspertizë mjeko ligjore shumën prej njëzet (20) Euro, për paushallin gjyqësor shumën prej njëzet (20) Euro dhe në emër të taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimit po ashtu shumën prej njëzet (20) Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë.

III. I dëmtuari V. J., me vendbanim në rrugën “...” në P., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregull juridiko civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka ushtruar aktakuzën PP/II.nr. 755/2023F, të datës 28.12.2023, kundër të pandehurit L. D., për shkak të veprave penale: “Dhuna në familje”, nga neni 248 par. 1 të KPRK-së dhe “Lëndim i lehtë trupor” nga neni 185 par. 3 nën-par. 3.1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 07.02.2024, në të cilën pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit dhe pasi bindet se i pandehuri e kupton aktakuzën, në kuptim të nenit 241 par. 4 të KPP-së, të njëjtit i ka ofruar mundësinë e deklaramit rreth fajësisë - të pranojë fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar apo të deklarojë i pafajshëm.

I pandehuri në seancën e shqyrtimit fillestar, pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij, ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar, ka shprehur keqardhje për ngjarjen e cila ka ndodhur si pasojë e pakujdesisë së tij, me të dëmtuarin janë në raport fqinjësor dhe raportet mes tyre janë rregulluar, ka premtuar se në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm

dhe nuk do të përsëris veprën penale, nga gjykata ka kërkuar që të njëjtit t'i shqiptojë një sanksion më të butë penal.

Gjyqtari i vetëm gjykues vërteton se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike, andaj gjatë marrjes në konsideratë të pranimit të fajësisë nga i pandehuri, mori pikëpamjet e prokurorit të shtetit dhe mbrojtësit të pandehurit.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit sepse ky pranimi fajësie ka mbështetje në shkresat e lëndës si dhe bazë ligjore konform dispozitave të KPP-së, andaj propozuar që gjykata ta aprovoi pranimin e fajësisë nga i pandehuri.

Mbrojtësi i të pandehurit lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga i mbrojturi i tij pasi që pranimi i fajësisë nga i njëjti është bërë pas konsultimit të mjaftueshëm me të si mbrojtës, nga gjykata ka kërkuar që pranimin e fajësisë nga i mbrojturi i tij ta merr si rrethanë lehtësuese me rastin e caktimit të sanksionit penal.

Gjyqtari i vetëm gjykues pas pranimit të fajësisë nga i pandehuri si dhe marrjes në konsideratë të pikëpamjeve të prokurorit të shtetit dhe mbrojtësit të pandehurit, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës, vërteton se në veprimet inkriminuese të pandehurit të ndërmarra në kuadër të dashjes së tij, manifestohen elementet qenësore të figurës së veprës penale “Rrezikimi i trafikut publik” nga neni 370 par. 8 lidhur me par. 6 dhe par. 1 të KPRK-së, andaj pasi që më parë gjeti se në aspektin penal-juridik është përgjegjës, të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi sanksionin penal si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata mori parasysh të gjitha rrethanat e mundshme lehtësuese dhe ato rënduese të parapara me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, të cilat janë me ndikim me rastin e marrjes së vendimit, ashtu që në rastin konkret si rrethana lehtësuese mori parasysh pranimin e fajësisë nga i pandehuri, keqardhjen e shprehur, premtimin se në të ardhmen nuk do të përsëris veprën penale, kërkim falje dhe pajtimi me palën e dëmtuar, ndërsa rrethana rënduese nuk gjeti, andaj nga arsyet dhe rrethanat e sipër theksuara vlerëson se dënimi me kusht si dënim alternativ i shqiptuar të pandehurit, është adekuat dhe në proporcion me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të tij, me bindje se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit me kusht i paraparë me nenin 47 të KPRK-së, i cili konsiston në risocializimin e të pandehurit me anë të pezullimit të dënimit, me të cilin dënim të pandehurit seriozisht i tërhiqet vërejtja dhe i bëhet me dije se nëse i njëjti kryen vepër tjetër penale brenda periudhës së verifikimit, gjykata do të revokojë dënimin me kusht dhe do të urdhërojë ekzekutimin e dënimit të caktuar në dënimin me kusht.

Vendimi mbi mundësinë e revokimit të dënimit me kusht është marrë në bazë të nenit 50 të KPRK-së.

Vendimi mbi lirimin e të pandehurit për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale është marrë në bazë të nenit 452 par. 4 të KPP-së.

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest të rregullt juridiko civil është marrë në bazë të nenit 462 par. 2 të KPP-së.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të neneve 242 dhe 364 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal
P.nr. 434/2023, Datë 01.03.2024

Procesmbajtëse
Erblina Aliu

Gjyqtari i vetëm gjykues
Besnik SHEQIRI

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmes kësaj Gjykate.